

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist II, Drejtorja e Mbështetjes së Ekzekutimit të Vendimeve të Prishjes,
(Kategoria, IV-a).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë Bachelor (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialisti II varet direkt nga Drejtori i Drejtorisë dhe ka detyra si më poshtë:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Merr pjesë në ekzekutimin e vendimeve të prishjes të vendosura nga institucioni;
3. Mban përgjegjësi për përcjelljen e informacionit të rezervuar në kushte të larta diskrecioni dhe njëkohësisht për ruajtjen e konfidencialitetit të nevojshëm gjatë ndërhyrjeve të ekzekutimit;
4. Sipas porosive të eprorëve, kujdeset për dokumentimin filmik dhe/ose fotografik te realizimit të ndërhyrjeve të ekzekutimit;
5. Siguron territorin ku realizohet ndërhyrja, me qëllim parandalimin e aksidenteve apo futjen e personave të paautorizuar.

Dokumentat që aplikanti për Specialist II, në Drejtorinë e Mbështetjes së Ekzekutimit të Vendimeve të Prishjes duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë Bachelor dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 14.10.2024 **ora** 16.30.